



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT

Drejtoria	Drejtoria e Shëndetësisë
Periudha Raportuese	Shtator, 2019
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Dr. Bujar Gashi

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Gjatë muajit shtator 2019, Drejtoria e Shëndetësisë ka pranuar 48 lëndë për t'u shqyrtuar nga komisioni profesional. Stafi në këtë drejtori ka pasur takime të përditshme me qytetarë, për t'u njoftuar me procedura dhe me shërbime sipas interesit dhe kërkesave të tyre.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas plan programit të Komunës për drejtorinë tuaj:

- Renovime dhe përmirësimeve të infrastrukturës në objekte shëndetësore;
- Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës;

- Monitorimi i mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj, si dhe në QMU;
- Inicimi i përgatitjeve administrative, zbatimi i planprokurimi 2019;
- Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të Drejtorisë;
- Shqyrtimi i mjeteve të ankimit me rrugë administrative.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë:

- Zhvillimi dhe monitorimi i kontratave:
 - Renovim i hapësirave: kati përdhes, QMF 5;
 - Renovime dhe përmirësime të infrastrukturës së objekteve shëndetësore në hapësira të ndryshme, bazuar në gjendjen aktuale të tyre;
 - Furnizim me barna dhe material shpenzues mjekësor;
 - Dezinsektimi hapësinor në komunën e Prishtinës;
 - Takime dhe njoftime të vazhdueshme të ekipit menaxhues;
 - Furnizim me material shpenzues stomatologjik;
 - Furnizim me material shpenzues laboratorik dhe RO Kabineti;
 - Pastrimi i objekteve shëndetësore;
 - Furnizim me material administrativ shëndetësor;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së përditshmërisë të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj, si dhe në QMU;
- Takime të vazhdueshme me menaxhmentin QKMF dhe QMU në lidhje me përditshmërinë e punës me qytetarë;
- Bashkëpunim me ekipet menaxhuese; Plan menaxhimi i kontratave – Proces prokurimi;
- Fillim i menaxhimit të aktiviteteve:
 - Furnizim me pajisje mjekësore;
 - Furnizim me inventar për nevojat e Institucioneve shëndetësore;
- Procedim përfundimtar i specifikave për procedure të tenderimit:
 - Renovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së QMU-së;
 - Procedurë negociuese – Sigurimi fizik i objekteve të KPSH-së;
 - Furnizim me pajisje mjekësore – pjesa II;
- Përcaktimi i ekipit menxhues:
 - Furnizimi me inventar për nevojat e institucioneve shëndetësore;
 - Furnizim me pajisje mjekësore;

- Realizohen dy faza shtesë të dezinfektimit në komunën e Prishtinës;
- Takim pune me kolegë DIMK dhe OE rreth projektit “Ndërtimi i QMF Prishtina e Re – Zona perëndim”;
- Rifunksionalizimi i SISH në QKMF me njësitë e saj; Planifikim i stafit rreth rifunksionalizimit të SISH – PKS;
- Pjesëmarrje në trajnim rreth proceduarve bazike të aktivitetit të prokurimit;
- Identifikimi i nevojave dhe përpilimi i buxhetit 2020;
- Rishikim i planprogramit të aktiviteteve për zhvillim të vazhdueshëm profesional;
- Plotësime të Planmenaxhimit të kontratave të ndryshme;
- Përgatitjet teknike mbi përpilimin e Planprokurimit 2020;
- Përgatitjet teknike – Plani i veprimit 2020;
- Mbështetje teknike mbi organizimin e “Muajit kundër kancerit të gjirit”;
- Njoftim mbi kushtet teknike rreth renovimeve në QMF 2 – barnatore, hemodializa nga QKUK.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtorja juaj për muajin raportues

- Monitorimi i kontratave:
 - Furnizim me material administrativ shëndetësor;
 - Furnizim me material shpenzues stomatologjik;
 - Renovime dhe rindërtime;
 - Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve shëndetësore të kujdesit parësor shëndetësor;
 - Dezinfektimi hapësinor në komunën e Prishtinës;
- Mbikëqyrje e vazhdueshme e punës së përditshme të personelit shëndetësor në objektet shëndetësore rreth mbarëvajtjes së punës;
- Organizimi dhe mbajtja e komisioneve për ndarje të subvencioneve – qytetarëve për ndihmë gjatë trajtimit mjekësor.

5. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtorja juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

5.1.1. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese.

5.1.2. Takimet me palë

- Rreth 9 – 10 palë gjatë ditëve të punës janë pranuar, me përjashtim të palëve të pranuar nga drejtori.

5.1.3. Takimet me institucioneve tjera:

- Drejtoria e investimeve kapitale:
 - o Menaxhim i kontratës “Renovime dhe rindërtime”;
- Drejtoria e Prokurimit:
 - o Procedura rreth kontratave të ndryshme;
- Drejtoria e Pronës:
 - o Kushtet ndërtimore – renovimi QMU-së;
- Drejtoria e Mirëqenies Sociale:
 - o Bashkëpunim në aktivitetin e ndarjes së subvencioneve;
- Drejtoria e Arsimit:
 - o Furnizim me dru – AMF;
- Njësia për të drejta të njeriut dhe barazi gjinore:
 - o Organizimi i Muajit kundër kancerit të gjirit;
- Zyra për të drejta të njeriut dhe komunitete:
 - o Organizimi i Muajit kundër kancerit të gjirit.

5.1.4. Diskutime publike/takimet me qytetarë

5.1.5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

- Drejtoria e Pronës:
 - o Kushtet ndërtimore – renovimi QMU-së.

5.1.6. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër:

- Të pranuar në DSH ishin 48 lëndë, prej të cilave 47 janë në proces dhe 1 është miratuar.

5.1.7. Përfitues të subvencioneve:

5.1.8. Takime të tjera:

- Ministrinë e Shëndetësisë;
- Organizata e shëndetit mendor;

6. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë:

- Mungesa e stafit në DSH;
- Mungesa e shefit të Sektorit tani e sa vite;
- Numri jo i mjaftueshëm i stafit shëndetësor, bazuar në nevoja të qytetarëve;
- Buxhet jo i mjaftueshëm, sidomos për kategorinë "Mallra dhe shërbime", ku me rritjen e numrit të pacientëve dhe shërbimeve, rrezikojmë shërbimet e vazhdueshme deri në fund të vitit.

7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR PERIUDHËN PASUESE

- Përgatitjet për publikimet e tenderëve bazuar në planin e prokurimit;
- Monitorim i përditshmërisë së personelit, për të ndikuar në shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme;
- Aktivitete për të ngritur cilësinë e shërbimeve shëndetësore.

8. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme

AKTIVITETET NË QENDRËN KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE

Aktivitetet vetëdijesuese:

- Më 11 dhe 18.09.19, është mbajtur ligjërata: "Syndroma e lodhjes kronike";
- Më 12, 19 dhe 23.09.19, është mbajtur trajnimi 3-ditor ToT "Përfshirja e burrave dhe grave në barazi gjinore", organizuar nga PEN - (Peer Educators Network);
- Më 16, 20, 24, dhe 27.09.2019, në kuadër të Projektit për mjekimin e Infarktit akut në Kosovë", janë mbajtur ligjëratat për Trajtimin e hershëm të Infarktit të Miokardit;
- Më 17.09.2019, në "Hotel Internacional Prishtina" në Veternik, pjesëmarrje në takim të profesionistëve shëndetësorë rreth Situatës me Fruth në Kosovë dhe Evropë, të organizuar nga IKSHPK, në bashkëpunim me OBSH dhe MSH;
- Më 19.09.2019, është mbajtur takim pune në hotel "Nartel", me Grupin punues për hartimin e SOP "Përcaktimi i kriterëve për qëndrimin e pacientëve me TB në institucionet shëndetësore në KDSH dhe KTSH";
- Më 24.09.19, u mbajt takim pune me menaxhmentin e QKMF- së dhe anëtarët nga Drejtoria e Shëndetësisë lidhur me organizmin e aktiviteteve për Muajin e luftës kundër kancerit të gjirit, me ç'rast, më 26 shtator filloi ligjërata edukative

për komunitetin RAE në QMF1, si dhe u ftuan gratë për mamografi, më 30 shtator. Aktiviteti vazhdon tutje gjatë muajit tetor;

- Më 25 dhe 26.09.19, në QKMF në kuader të aktiviteteve të planifikuara nga "Hendikos", janë mbajtur "Sesionet informuese për promovimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtje të fëmijëve nga dhuna në familje", organizuar nga "Hendikos";
- Më 25.09.19, drejtori i SHSKUK-së dhe drejtori i KE-së, nënshkruan certifikatat për periudhën maj 2018 - mars 2019, për ekipet Mjekë/Infermierë, të cilët vijuan trajnimin "Kirurgjia e vogël dhe procedurat tjera emergjente", me kohëzgjatje 1 mujore;
- Më 25. 09. 2019, në sallën e bibliotekës së QZHMF-së, është mbajtur takim i grupit punues për hartimin e Udhërrëfyesit klinik "Menaxhimi i infeksionit latent të TB-së" organizuar nga Ministria e Shëndetësisë;
- Më 26.09.2019, u mbajt ligjëratë edukative në shkollën fillore "Mati Logoreci" në Prizren, me temën "Parandalimi i kancerit të qafës së mitrës";
- Më 27.09.2019, në kuadër të Planitprogramit për skringun e kancerit të qafës së mitrës, është mbajtur ligjërata për Pap-test, në SHF "Emin Duraku" në Prizren, organizuar nga AMC;
- Nga 30.09.19 - 02.10.19, në QZHMF vijoi trajnimi 3 ditor "Planifikimi familjar" organizuar nga AMC, në bashkëpunim me MSH, UNFPA dhe akredituar nga OMK.
- Më 30.09.19, është mbajtur takimi i Komitetit të Programit për skringun e kancerit të qafës së mitrës, në restorant "Rings", organizuar nga AMC (Aksioni Nëna dhe Fëmija);
- Më 30.09.19, u shënuar "Dita botërore e zemrës", me aktivitete për pacientë në hyrje të QKMF-së, duke ofruar shërbime shëndetësore, si matja e TA, vlerat e pulsoksimetrit, pesha trupore, si dhe materiali edukativ;
- Më 30 .09.19, u mbajt takim pune, organizuar nga AMC, ku u diskutuan hapat e mëtejme të Programit nacional rreth realizimit të Pap-testit në komunën e Prishtinës.
 - Në kuadër të pakos bazike, u mbajtën ligjërata edukative në shkolla, me temën: "Dhuna në shkollë dhe bulizmi", raportuan:
 - Më 11 shtator 2019, ligjërata në SHFMU " 7 Marsi" nga QMF 7;
 - Më 23 shtator 2019, ligjërata në SHFMU "Ismail Qemajli" nga QMF 6, " Mehmet Gjevori" nga QMF 8 dhe " Xhavit Ahmeti" nga QMF 9;
 - Më 25 shtator 2019, ligjëratë në SHFMU "Pavarësia" nga QMF Mati 1;
 - Më 26 shtator 2019, ligjërata në SHFMU "Hilmi Rakovica" nga QMF 2;
 - Më 27 shtator 2019, u organizua vizitë e QKMF-së nga nxënësit e SHFMU "Mehmet Gjevori".

Njësia e vaksinimit

Bazuar në Kalendarin e imunizimit, vazhdon vaksinimi i qytetarëve të komunës së Prishtinës.

Poliklinika stomatologjike

- Numri i pacientëve në shërbimin stomatologjik ishte - 6220;
- Numri i grafive - 706;
- Furnizim me material shpenzues stomatologjik nga OE;
- Vizitë e vazhdueshme nga kryeshefi, mbi përditshmërinë e personelit shëndetësor në ndërresat e ditës/natës dhe kujdestari;

Numri i pacientëve insulinëvartës që kanë marrë shërbim gjatë muaji gusht ishte - 1372.

Vizita mjekësore	Shërbimet shëndetësore	Shërbimet laboratorike	Shërbimet stomatologjike	Shërbimet radiologjike	Gjithsej
88759	59557	82182	15500	2629	248627

- Gjatë periudhës raportuese është ofruar transport për 56 pacientë - Hemodializa.

AKTIVITETET NË QENDRËN E MJEKËSISË URGJENTE

Gjatë periudhës raportuese, në QMU është punuar sipas orarit të punës, ku mesatarja e shërbimeve shëndetësore gjatë 24 orëve ishte rreth 120, përderisa e interevenimeve ishte 60 raste.

Nga raportimet e stafit mjekësor, rastet urgjente janë trajtuar sipas prioriteteve të triazhës dhe sipas këtyre raportimeve kanë dominuar rastet me:

- Intoxikime alimentare,
- Gastroenterokolitet akute,
- Lëndime në aksidentet e trafikut,
- Kriza hipertenzive,
- Reaksionet alergjike,
- Gjendje sinkope etj.

Vizitat shëndetësore vazhduan sipas thirrjeve nga ana e qytetarëve, në linjën tel. 194 në Qendrën Dispeçerike.

Mbështetje profesionale e aktiviteteve kulturore-sportive, edukimi dhe trajnimi jashtë orarit të rregullt:

- Më 06.09.19, nga ora 13:30 deri 18:00, ekipi mjekësor i QMU-së siguroi stërvitjet e dy kombëtareve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Çekisë – stadiumi i qytetit “Fadil Vokrri”;
- Më 07.09.19, u siguroa ndeshja zyrtare e kualifikimeve për Kampionatin Evropian, mes dy ekipeve kombëtare Kosovë – Çeki, zhvilluar në stadiumin “Fadil Vokrri”;
- Ekipet mjekësore të QMU-së asistuan në Amfiteatrin e Gërmisë për sigurimin e festivalit “ROCK UNITED” gjatë dy ditëve. Më 06.09.2019, duke filluar prej orës 21:00 - 1:00 dhe më 07.09.2019 prej orës 21:00 - 1:00;
- Më 11.09.19, ekipi mjekësor siguroi ndeshjen ndërkombëtare mes klubeve të femrave “Mitrovica” – “Wolfsburg” (Gjermani); morëm pjesë së bashku me Zjarrfikësit, FSK, Policinë e Kosovës dhe përfaqësuesit e Ambasadës së SHBA-ve në sheshin “Bill Klinton” në përkujtimin e viktimave të 11 shtatorit të vitit 2001 në Nju-Jork, organizuar nga shoqata “Miq të Amerikës”;
- Më 21.09.19, ekipi i QMU-së siguroi garat “Çiklistët e rinj” në qytetin e Prishtinës;
- QMU asistoi gjithashtu edhe me një ekip dhe autoambulancë, më 21 dhe 22 shtator në Grashicë, gjatë garës automobilistike. Gara është zhvilluar në organizim të klubit automobilistik “Prishtina”;
- Më 26.09.19, është mbajtur Kolegjiumi i mjekëve dhe ligjërata e radhës, me titull “Emergjencat psikiatrike dhe trajtimi paraspitalor”;
- Më 30 shtator, në kuadër të edukimit të nxënësve, kemi mbajtur një ligjëratë në Shkollën Model “Qamil Batalli” të komunës së Prishtinës, me temën “Njohja e nxënësve me veprimtarinë e QMU-së, ndihma e pare dhe intervenimet urgjente”. Ligjëratë është mbajtur nga dr. Isuf Bajrami dhe inf. Fehmi Haziri, me kërkesë të Drejtorisë së Shkollës, arsimtarëve, Këshillit të prindërve dhe të nxënësve;
- Të gjitha aktivitetet jashtë orarit të rregullt të punës, janë zhvilluar me miratim të DSH-së.

Me të njëjtën datë, pas kolegjiumit të mjekëve në kuadër të EVM-së, është mbajtur ligjëratë e radhës me temë:

- Çrregullimet e ritmit të zemrës (Bradikarditë dhe Tachikarditë);
- Auditi në QMU; koha e arritjes në vendngjarje, për muajt mars-prill-maj 2019.

Shërbimet në muajin shtator 2019 – QMU;

Vizita mjekësore në terren – 1094;

Vizita të tjera mjekësore – 212;

Vizita mjekësore në QMU – 532;

Shërbimi i kirurgjisë së vogël – 18;

Shërbimi i reanimimit terren – 2;

Shërbimi i reanimimit QMU – 0;

Shërbimi observim – 292;

Shërbimi i infermierisë – 128;

Aksidente – 81;

Fatkeqësi në punë – 3;

Fatkeqësi të tjera - 58;
Shërbimi laboratorik - 140;
EKG - 81;
Transportet - 368;
Konstatim vdekje - 43;
Gjithsej - 3052.